

Faqja e Fakteve 3

...*bindjet demokratike të cilat i kemi njëlloj...*

Qeveria Demokratike në Australi

Kushtetuta Australiane

Që nga ardhja e Britanikëve me 1788 deri me 1901, gjashtë qeveritë e Australisë janë qeverisur nga parlamentet e tyre të veçanta. Nga fundi i viteve 1800 njerëzit në koloni filluan të bisedojnë rreth mënyrave se si mund të formohet një parlament kombëtar për të qeverisur Australinë.

Pëfundimisht ato ranë dakord mbi një numër rregullash (një *Constitution* - kushtetutë), dhe njerëzit e kolonive votuan në referendume për të pranuar Kushtetutën. Në Marrëveshje me Parlamentin Britanik, kombi i njohur si Komonvelthi i Australisë u lind me 1 Janar 1901.

Kushtetuta u ishte e shkruar në vija të përgjithëshme në atë kohë. Kushtetuta është një numër rregullash për qeverisjen e Australisë të cilat duhet të ndiqen nga Parlamenti Federal. Ajo mund të ndërrohet vetëm nga një votë speciale e quajtur *referendum* (referendum).

Monarkia Kushtetuese

Australia është *constitutional monarchy* (monarki kushtetuese). Megjithëse është një shtet i pavarur, *Head of State* (Kryetari/a i/e Shtetit) të Australisë është Mbetëresha Elizabeth II e Britanisë së Madhe. Mbetëresha emëron *Governor-General* (Guvernatorin e Përgjithshëm) si përfaqësuesi i saj në Australi, me këshillën e Kryeministrit. Guvernatori i Përgjithshëm ka shumë fuqi, por në përgjithësi vepron vetëm nën këshillën e ministrave të qeverisë.

Fuqia e Mbetëreshës në Australi është e kufizuar nga Kushtetuta. Kohët e fundit ka pasë një diskutim rreth ndryshimit të statusit të Australisë nga monarki kushtetuese në *republic* (republikë) (ku njerëzit nëpërmjet përfaqësuesave të tyre, kanë pushtet absolut).

Populli Australian u pyet në një referendum me 6 Nëntor 1999 nëse donte të bënte këtë ndryshim. Ai votoi 55 për qind në krahësim me 45 për qind kundra ndryshimit.

Demokracia me përfaqësi

Australia është një *representative democracy* (Demokracia me përfaqësi). Ky është një sistem i qeverisjes në të cilin të gjithë Nënshetasit Australianë thojnë mendimin e tyre. Njerëzit që janë të ligjshëm për të votuar për dikë që t'i përfaqësojë ato dhe për të marrë vendime në Parlament në emër të tyre. Cilido Nënshetas Australian mund të emërohet për zgjedhje në Parlament.

Një *Parlament* është një grup njerëzish të zgjedhur nga votuesit për të bërë ligjet në emër të tyre. Parlamenti i Komonvelthit të Australisë përbëhet nga dy seksione ose Dhoma: Dhoma e përfaqësuesve dhe Senati.

House of Representatives (Dhoma e Përfaqësuesve) përbëhet nga 148 Anëtarë. Çdo Anëtar përfaqëson rreth 80 000 votues që jetojnë në një zonë të caktuar (*electorate* i tyre (elektorati)).

Anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve njohin njerëzit dhe çështjet lokale në elektoratin e tyre. Kur flasin në Parlament, ato flasin në emër të njerëzve në elektoratin e tyre, diskutojnë propozimet për ligjet e reja (*Bills*) dhe çështje të rëndësishme kombëtare.

Senate përbëhet nga 76 senatorë që përfaqësojnë Shtetin ose Territorin e tyre. Senatorët debatojnë çështjet aktuale, konsiderojnë Ligjet e Reja, raportet e komitetit dhe dokumentet e paraqitur (ose *tabled*) nga Ministrat në Parlament. Ato udhëtojnë të takohen me njerëzit në Shtetin e tyre dhe të çojnë pikëpamjet e tyre në Parlament.

Një pjesë shumë e rëndësishme e punës së anëtarëve të të dy Dhomave është votimi mbi ligjet e reja. Përpara se të miratohet një ligj i ri ose të ndryshohen ligjet egzistuese, një shumicë e Anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve dhe e Senatorëve duhet të bijnë dakord.

Parlamenti ka Anëtarë dhe Senatorë nga parti ose grupe politike të ndryshme. Ka gjithashtu dhe të pavarur që nuk i përkasin ndonjë partie. Aktualisht në Australi katër partitë politike më të mëdha janë Partia Liberale, Partia e Punës, Partia Kombëtare dhe Demokratët Australianë.

Udhëheqësi i partisë (ose partive) që fiton shumicën e vendeve në Dhomën e Përfaqësuesve bëhet kryetari/ja i/e Qeverisë. Kryetari/ja i/e Qeverisë thirret *Prime Minister* (Kryeministër).

Kryeministri/ja është udhëheqës/e i/e të gjithë kombit. Ai ose ajo është zëdhënës/i/ja për Australinë në mbledhjet dhe ngjarjet ndërkombëtare.

Kryeministri/ja zgjedh Anëtarët ose Senatorët për *Ministers* (Ministra). Partia politike që fiton vendin e dytë më të madh të vendeve quhet *Opposition* (Opozitë). Udhëheqësi i saj quhet *Leader of the Opposition* (Udhëheqësi i Opozitës). Roli i opozitës është të kontrollojë çfarë bën Qeveria dhe të paraqesë ide të tjera se si drejtohet vendi.

Nivelet e qeverisjes

Australia ka tre nivele qeverisje, Qeveria Federale, e Shtetit dhe Lokale (me përjashtim të ACT që nuk ka Qeveri Lokale). Secili nivel siguron shërbime të ndryshme për njerëzit.

Federal Government (Qeveria Federale) gjendet në Kanbera. Ajo zbaton ligjet e miratuara nga Parlamenti i Komonvelthit. Ajo është per/gjegjëse për:

- € taksat
- € ekonominë
- € emigracionin dhe doganat
- € punësimin
- € shërbimet postare dhe telekomunikacionet
- € pensionet dhe ndihmën për familjet
- € forcat e mbrojtjes
- € tregtinë
- € aeroportet dhe sigurimin ajror
- € marrëdhëniet me vendet e tjera (punët e jashtme)

State dhe Territory Governments (Qeveritë e Shtetit dhe Territorit) kanë bazën në kryeqytetin e çdo Shteti ose Territorit. Ato zbatojnë ligjet e miratuara nga Parlamentet e tyre mbi çështjet e Shtetit ose të Territorit. Këto përfshijnë:

- € spitalet
- € shkollat
- € hekurudhat
- € rrugët
- € pyjet
- € policinë

Si me Parlamentin e Komonvelthit, njerëzit votojnë për të zgjedhur një përfaqësues për zonën e tyre. Ky/kjo përfaqësues/e është një Anëtar/e i/e Parlamentit të Shtetit. Në çdo Shtet, *Premier* (Kryeministri i Shtetit) është udhëheqësi i Qeverisë së Shtetit. Në çdo Territor, *Chief Minister* (Ministri Kryesor) është udhëheqësi i Qeverisë.

Çdo Shtet me përjashtim të Kuinslandës, ka dy Dhomat e Parlamentit (njëlloj si Parlamenti Federal). Dhoma e Ulët quhet *Legislative Assembly* (Asambleja Ligjvënëse), dhe Dhoma e Lartë quhet *Legislative Council* (Këshilli Ligjvënës). Parlamentet e secilit Territor kanë një Dhomë që njihet si Asambleja Ligjvënëse.

Local Councils (Komunat Lokale) marrin vendime mbi çështjet lokale, të qyteteve të vogla dhe të qyteteve të mëdha. Këto përfshijnë:

- € shenjat e rrugëve dhe kontrollet e trafikut
- € kanalet e kullimit dhe trotuaret
- € qendrat e kujdesit për fëmijë
- € komplekset sportive
- € bibliotekat
- € grumbullimin e mbeturinave
- € pishinat
- € lejet e ndërtimit

Ka rreth 850 zona komunash lokale në Australi. Populli i çdo zone zgjedh anëtarët e komunave lokale për t'i përfaqësuar ato. Këto anëtarë quhen këshillëtarë ose kryeplak/kryeplakë. Udhëheqësi i tyre quhet *Mayor* (Kryetar Bashkie) ose *Shire President* (Presidenti i zonës Administrative). Edhe në zgjedhjet e komunave votimi është i detyrueshëm.